

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj e Lumni Sallauka – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses SH.A. nga Gjilani, rr. "...", nr..., kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Arsim, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesi ligjor B.D., për kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjelljese në pension, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.802/2011, të datës 25.02.2015, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 17.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses SH.A. nga Gjilani , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.802/2011, i datës 25.02.2015, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.802/2011, të datës 25.02.2015, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses SH.A., në bazë të së cilës ka kërkuar që e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Arsim në Gjilan të detyrohet t'ia paguaj dy paga për shpërblim jubilar, dy paga përcjelljese dhe regresin, të gjitha këto në shumë prej 1,534.00 €, ma kamatë që bankat e paguajnë për depozitimet për një vit, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e SH.A. nga Gjilani dhe ta anuloj aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.802/2011, të datës 25.02.2015.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja SH.A. me datë 24.11.2011, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e pagave pas pensionimit kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e

paditura që paditëses t'ia paguaj pagat pas pensionimit në vlerë të tërësishme prej 1534 € dhe atë me kamatë ligjore prej 3.2 % ashtu sa paguajnë bankat në Kosovë dhe atë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancë të shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.802/2011, të datës 25.02.2015, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar dhe sqaruar se kontrata kolektive për shkaqe të komplikimeve buxhetore nuk është aplikuar asnjëherë përveç rasteve të lehonisë, duke shtuar se nuk është kontestuese fakti se paditësja SH.A. ka qenë në marrëdhënie pune në arsim në Shkollën Fillore dhe të Mesme të Ulët "Selami Hallaqi", dhe se të njëjtës i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datën 13.08.2011, për shkak të moshës së pensionit, e cila edhe vërtetohet me aktvendimin mbi ndërprerjen e punës nr.657/11. Më tutje gjykata ka theksuar se kur paditësja ka shkuar në pension të pleqërisë, Kontrata Kolektive fare nuk ka qenë në fuqi, edhe sipas kësaj punëdhënësit nuk kanë për obligim t'i kryejnë detyrimet sipas kësaj kontrate.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur së është vendosur në mënyrë të drejtë duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë pasi që nga shkresat e lëndës rezulton së nuk ka qenë rrethanë kontestuese fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri në arritjen e moshës së pensionit, përkatësisht deri me datën 02.08.2011. Kjo rrethanë është provuar edhe nga vendimi i të paditurës i datës 02.08.2011, për pensionimin e punëtores, këtu paditëses. Kontrata Kolektive ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2005, me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite përkatësisht deri me datën 31.12.2007, kur të njëjtës i ka skaduar afati i zbatimit përkatësisht i ka pushuar efekti juridik, ndërsa kontrata tjetër kolektive ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2015 e deri me 31.12.2017. Edhe sipas dispozitës së nenit 90 paragrafi 4 i Ligjit të Punës, përcaktohet se "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet*".

Me skadimin e afatit të Kontratës Kolektive, e njëjta nuk mund të aplikohet për rastet tjera pas datës 01.01.2008, e as për rastin e paditëses meqë padia është paraqitur në gjykatë

me datën 24.11.2011, ndërsa paditësja është pensionuar me datën 02.08.2011, pasi që ka pushuar së zbatuari Kontrata e Përgjithshme Kolektive.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1937/15, me datë 17.09.2018

Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari,
Valon Totaj